

Prishtinë, 12/11/2007  
Kodi i ZRrE-s: D\_72\_2007

## **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/8 “Mbi Energjinë”;
2. Dispozitat e Ligjit nr. 2004/9 “Mbi Rregullatorin e Energjisë”;
3. Dispozitat e Udhëzimit të Përkohshëm I\_05\_2007 “Mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave dhe Çmimeve në Sektorin e Ngrohjes Qendrore në Kosovë për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”;
4. Aplikacionin për tarifat e ngrohjes për sezonin e ngrohjes 2007/2008 dorëzuar nga ana e Ngrohtores së Qytetit (NQ) Termokos SH.A., Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) më datë 20 shtator 2007;
5. Komentet për aplikacionin për tarifa të dhëna nga ana e ZRrE-së me datë 25 shtator 2007;
6. Aplikacionin për tarifat, të rishikuar, të NQ Termokos SH.A. dorëzuar me datë 02 tetor 2007;
7. Vendimin D\_70\_2007 për Përcaktimin e të Ardhurave të Lejuara për NQ Termokos SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008, nxjerrë nga ana e ZRrE-së me datë 01 nëntor 2007, shoqëruar nga ANEKSI “RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i të Ardhurave të Lejuara për NQ Termokos SH.A., për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”;
8. Propozimin e tarifave – detajet për llogaritjen e tarifave – dorëzuar nga ana e NQ Termokos SH.A., Zyrës së Rregullatorit për Energji më 06 nëntor 2007;

**Ka vendosur që:**

1. Të aprovojë tarifat për NQ Termokos SH.A. për tërë gjashtëmuajorin e sezonit të ngrohjes 2007/2008 siç është paraqitur në tabelën “A” dhe “B” dhe llogaritja detale e paraqitur në ANEKS-in e këtij vendimi “ RAPORTI RREGULLATIV – Përcaktimi i Tarifave për NQ Termokos SH.A. për Sezonin e Ngrohjes 2007/2008”.

**TARIFAT PËR NGROHTOREN E QYTETIT TERMOKOS SH.A.  
PËR SEZONIN E NGROHJES 2007/2008**

**Tabela A. TARIFA PËR KONSUMATORËT E PA-MATUR**

| NGROHTORJA E QYTETIT TERMOKOS SH.A.                                    |                                    |  |
|--|------------------------------------|--|
| Komponentet e Tarifave   | Amvisri<br>m <sup>2</sup> për muaj | Komerical - Institucional<br>m <sup>2</sup> për muaj |
| Tarifa për kapacitetin e kontraktuar të ngrohjes<br>(komponenta fikse) | € 0.11                             | € 0.13   |
| Tarifa për ngrohjen e furnizuar<br>(komponenta variabile)              | € 0.68                             | € 0.82   |

**Tabela B. TARIFA PËR KONSUMATORËT E MATUR**

| NDËRMARRJA E NGROHJES QENDRORE "TERMOKOS"                     |               |
|---|---------------|
| Tarifa mujore e kapacitetit të ngrohjes<br>(komponenta fikse) | € 1.09 / kW   |
| Tarifa për ngrohjen e furnizuar<br>(komponenta variabile)     | € 41.00 / MWh |

2. Tarifat e aprovuara do të publikohen nga ana e NQ Termokos SH.A. në njërin nga gazetatat kombëtare dhe lokale që qarkullojnë në Kosovë, brenda (5) ditëve të punës, pas shpalljes dhe publikimit të vendimit nga ana e ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit dhe zbatohet nga data e publikimit në faqen elektronike zyrtare të ZRrE-së.
4. Ky vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis versioneve të ndryshme, do të sundojë versioni në gjuhën shqipe.
5. NQ Termokos ka të drejtë ankese ndaj vendimit të ZRrE-së duke dorëzuar raportin e plotë të dëshmuar brenda dhjetë (10) ditësh kalendarik pas shpalljes dhe publikimit të këtij vendimi të ZRrE-së në faqen e saj zyrtare në internet.

Vendimit i bashkëngjitet Raporti Rregullativ i Përcaktimit të Tarifave për NQ TERMOKOS  
SH.A. Sezoni i Ngrohjes 2007/2008.

Bordi i ZRrE-së:

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Naim Bejtullahu, Anëtar

---

Nysret Avdiu, Anëtar